

PROCESVERBAL 24/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 5 (pestë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 24.05.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori” ;

5.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë në për këtë projekt-vendim bëhet fjalë për katër banesat të cilat komuna i ka në posedim dhe në shfrytëzim në rrugën “Brigada 123”.Komuna i ka liru këto objekte dhe ka fillu procedurat e dhënies në shfrytëzim me qira dhe besojmë dhe shpresojmë që këto banesa do ti dedikohen familjeve të dëshmorëve.Ne do ti vazhdojmë procedurat ligjore ashtu sikurse e kërkon ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet Pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që komuna që nga viti 2010 i heq shpenzimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës mirëpo deri më tani ne kemi shku përmes kategorisë mallra dhe shërbime mirëpo qeveria e RKS-së tash e tutje mjetet i ka nda dhe i ka dediku në kategorinë e subvencioneve dhe ne e kemi obligim ligjor që vendimin paraprakisht ta marrim në Kuvend dhe ta përcaktojmë një shumë.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Denis Sofra - p.sh. nëse një familje po don ti kryej procedurat por i bën shpenzimet vet dhe bashkësia islame nuk është e njoftuar.Çka nëse bashkësia islame e merr si listë që personi ka vdek por procedurat nuk i kryen?

Avni Bytyqi - kjo është çështe vullneti se a don me i kry shpenzimet përmes komunës apo don me i kry shpenzimet vet familjari mirëpo komuna i ka kriju një mundësi qytetarëve që t'ja heq shpenzimet e varrimit në rastet e vdekjeve të familjarëve të tyre dhe në momentin që kur familjari vjen dhe raporton në komunë që i ka kryer obligimet vet,bashkësia islame nuk ka të drejtë që ta sjell raportin .

Denis Sofra - Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet Pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori” ;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime sa i përket kësaj pike dhe thotë që komisioni i themeluar nga Kuvendi i ka shqyrtuar të gjitha propozimet që kanë ardhë për mirënjohjen “13 Qershori” dhe Kuvendit i ka propozuar këta të nominuar: për shpërblimin “Emblema e Artë” ka propozuar që ti ndahet Hysen Q. Gegaj nga fshati Sallagrazhdë ndërsa për çmimin “Skënderbeu” i ka propozuar kuvendit që të jenë dëshmorët Mehmetali J. Ajvazi nga fshati Livoq i Epërm Komuna e Gjilanit dhe Lulëzim Veselaj nga fshati Reqan Komuna Suharekë.Mirënjohja “13 Qershori” i ndahet këtyre të nominuarve: Rifat I. Aliaj nga fshati Maqitevë(postmortum), Sherif S. Sellaj nga fshati Samadraxhë(postmortum),Ilmi R. Bujari nga fshati Duhël, Mehmet H. Mustafa nga fshati Mushtisht dhe të gjithë ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës(UÇK të Komunës së Suharekës) që kanë qenë pjesar të “Brigada 138 Agim Ramadani” në Koshare.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 4.

Aprovohet Pika 4

Pika 5.Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - kam një kërkesë për lojrat e fëmijëve në fshatin Gelancë.Lojrat janë prish dhe të paktën një kamion zallë me vendos dhe me i forcu ato lojëra sepse tash është vera dhe fëmijët duhet të luajnë.

Avni Bytyqi - ka qenë donacion i një organizate dhe çështja e mbikëqyrjes nuk e di si shkon por unë këtë shqetësim do ta adresoj te Drejtori i Shërbimeve Publike.

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit.Unë sot kam ardhë për përkrahjen tuaj.Komuna e Suharekës me shumë respekt dhe me shumë përgjegjësi e ka parasysh realizimin,mbrojtjen dhe krijimin e kushteve për komunitet të cilat ekzistojnë në komunën tonë.Ju e dini që ka pas mbështetje,përkrahje për ju dhe po ashtu edhe në të gjitha aktivitetet,takimet që ne i organizojmë,ju jeni pjesë të barabartë e të gjitha aktiviteteve tona.Është mos angazhimi juaj krahas këtyre aktiviteteve ku unë shumë herë kam bërë ftesa dhe pjesëmarrja ka qenë shumë e vogël ose fare.Andaj unë ju inkurajoj sidomos gjininë femërore që të jeni pjesëmarrës të këtyre takimeve dhe këshilla ime është që ju ti pranoni detyrat dhe përgjegjësitë tuaja.

Takimi përfundoi: 09:20